

Prodhimtaria e Turqisë në vitin 2013 ka arritur në rreth 100 trilion dollarë dhe ka bërë një kërcim, nga pozita e 111-të e vendeve më të fuqishme në botë në vendin e 16, që do të thotë se me një mesatare prej afro 10% ai do të arrijë që të hyjë në G20-të, e që janë 20 vendet më të fuqishme në botë.

Kryeministri i Turqisë, Recep tayyip Erdogan, ka paraparë që Turqia në vitin 2030 të jetë vendi më i fuqishëm në botë, si në aspekt politikë e po ashtu edhe në atë ekonomikë. Se a do të ia arrijë që gjëje të tillë, na mbetet që të ua lëmë ditëve në vijim që të na e zbulojnë këtë parashikim.

Aeroporti Ndërkombëtarë i Stambollit është më i madhi në Evropë. Ky aeroport gjatë ditës pranon rreth 1260 atertime duke mos e harruar edhe atë të Sabihas që ka kapacitete të pranojë deri në 630 atertime brenda ditës.

Turkish Airlines është kompania që për tri vite radhazi është duke e fituar çmimin "Kompania më e mirë ajrore" në botë.

Në dhjetë vite, Turqia ka bërë mbjelljen e 2 miliardë e 770 milionë pemë pyjore dhe frutore.

Turqia kanë arritur për herë të parë të prodhojnë tanke të blinduara, transportues ajrorë, aeroplanë pa pilot, satelitin ushtarakë që ka aftësi dhe mundësi të kryej më shumë se një veprim.

Dhjetë vitet e fundit, ka ndërtuar 125 universitete të reja, 189 shkolla, 510 spitale, 169 mijë klasa në mënyrë që të mos ketë në një klasë më shumë se 21 nxënës.

Kur kriza ekonomike ishte intensifikuar në Evropë dhe në Amerikë, kishte detyruar këto të dyja që të ngritin tarifat e shkollimit ndërsa Erdogani kishte lëshuar një dekret me anë të së cilit kishte bërë falas shkollimin në të gjitha nivelet dhe në të gjitha institucionet shtetërore dhe çdo shpenzim do të mbulohej nga shteti.

Deri para dhjetë viteve, të hyrat vjetore për kokë banori kanë qenë 3500\$ ndërsa në vitin 2013 ajo u ngritë në 11000\$ dhe është më e lartë sesa të hyrat e një personi në Francë. E po ashtu edhe vlerën e monedhës turke e ka ngritur për 30 herë.

Në Turqi, qeveria është duke dhënë maksimumin e saj që të nxjerrë 300 mijë studiues dhe të i angazhojë vetëm për studime dhe hulumtime në mënyrë që të mund të ia arrijë qëllimeve të saja deri në vitin 2023.

Arritja më e madhe politike është marrëveshja paqësore dhe ndalja e gjakut që është bërë rreth Qipros dhe PKK, si dhe kërkim-falja që ju bë popullit armen për një krim që kishte ndodhur para më shumë se nëntë dekada.

Në Turqi pagat janë rritur 300% dhe paga minimale e një punëtori është ngritur nga 150 dollarë në 420 dollarë dhe papunësia ka rënë nga 38% në 2%.

Buxheti i arsimit dhe shëndetësisë ka tejkaluar buxhetin ushtarak andaj edhe paga e një

mësimdhënësi është e barabartë me atë të mjekut.

Janë ndërtuar 35000 salla laboratorike të teknologjisë informative dhe asaj grafike në mënyrë që të rinjtë turq të kenë mundësi të përgatitjes profesionale dhe praktikës në to.

Erdogani mbulojë deficitin e shtetit që kishte arritur në 47 miliardë dhe pagojë këstin e fundit të borxhit në Bankën Botërore. Borxh ky që kishte arritur shumë prej 300 milionë dollarë dhe u pagua në qershor të vitit të kaluar por jo vetëm kaq, Turqia ka arritur edhe që ti jap borxh po këtij fondi shumë prej pesë miliardë, e po ashtu ai ka arritur që në fondin e përgjithshëm të kursejë edhe 100 miliardë dollarë në një kohë kur Amerika dhe Evropa ishin nën presionin e barrës së dështimeve nga borxhet, fajdetë dhe falimentimet e mundshme.

Eksportet e Truqisë, para dhjetë viteve, ishin 23 miliardë ndërsa më vonë u bënë 153 miliardë për të arritur deri tek 190 shtete në mbarë botën.